



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 126, Datë 08.08.2019

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 08.08.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin korrik 2019,

Konstatoi se:

- OSHEE sh.a, me shkresën nr.16348 Prot, datë 25.07.2019 paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2019.
- Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike tek klientët e FMF-së për muajin Korrik 2019 të jetë 12.75 lekë/kWh .
- Llogaritjet e OSHEE sh.a si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Korrik 2019 sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar me vendimin nr.144, datë 25.06.2018, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi per FMF per muajin Korrik 2019

Korrik 2019		Aplikimi OSHEE Sh.a		Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
a	Cmimi maksimal I blerjes ne treg te parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi	Leke/kWh	8.46	8.46
b	Kthimi per riskun I percaktuar ne pergjinde per vitin (3%)	Leke/kWh	0.25	0.25
c	Cmimi maksimal I blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	8.71	8.71
d	Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
e	Tarifa e perdorimit te rrjetit te transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
f	Tarifa e perdorimit te rrjetit te shperndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Cmimi I energjise (c+d+e+f)		Leke/kWh	12.75	12.75

OSHEE sh.a, për muajin korrik 2019, ka zhvilluar një procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar, ku çmimi maksimal i blerjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2019 prej 63.5 Eur/MWh, i përket energjisë elektrike të blerë nga shoqëria EFT AG Loti 1, realizuar në datën 26.06.2019 për sasinë totale prej 66,960 MWh me një vlerë prej 4,251,960 Euro ose 518,739,120 lekë.

Nga analiza e informacionit mbi procedurat e blerjes së energjisë elektrike të dorëzuar nga OSHEE sh.a. bashkëlidhur aplikimit për çmimin FMF për muajin Korrik 2019, data 26.06.2019 është dita e mbylljes së procedurës të blerjes nga tregu i parregulluar për të cilën kursi i këmbimit sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë rezulton 1EUR= 122 lekë

- Në aplikimin për çmimin FMF për muajin korrik 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektesë përcaktimet e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 të Bordit të ERE-s” për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.
- Meqënëse çmimi i realizuar nga blerja në tregun e parregulluar (7.75 lekë/kWh) ka rezultuar më i ulët se çmimi i blerjes nga prodhuesit me përparësi (8.4582 lekë/kWh) i miratuar me vendimin nr. 8, datë 17.01.2019 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019” të Bordit të ERE-s, ky I fundit është marrë në konsideratë nga OSHEE për llogaritjen e çmimit të FMF për muajin Korrik 2019.
- Shoqëria vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktivitetit të Furnizimit dhe Shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostot e disbalancave për klientët e FMF.
- Gjëndur në kushtet e pamundësisë së ndarjes së kostove të FMF nga ato të FSHU, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) është e arsyeshme të pranohet koston për njësi prej **1.79 lekë/kWh** të paraqitur nga OSHEE sha.
- Në zbatim të detyrës së lënë nga bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 10.07.2019, ERE risolli në vëmendjen e OSHEE sh.a. detyrat e lëna me shkresën nr. 109/3, datë 27.03.2019, lidhur me mungesën e evidentimit të kostove të disbalancave si dhe faturimit në pik nga ana e OSHEE sh.a. për klientët që furnizohen nga FMF.
- OSHEE sh.a. me shkresën nr.14962, datë 26.07.2019 bën me dije se, përsa i përket faturimit të konsumit në tarifën Aktiv pik të klientëve në cilësinë e FMF-së, dhe në lidhje me evidentimin e kostove të administrimit dhe të disbalancave për klientët e FMF, OSHEE sh.a e ka informuar ERE mbi arsyet e faturimit në tarifën Aktive pik dhe si duhet të trajtohen (faturohen) konsumatorët të cilët kanë sistem matje të tillë që kanë sistem leximi Aktiv dhe Pik dhe jo total indeks leximi Aktiv (kWh).
- Ky argumentim i OSHEE sh.a. nuk mund të mbështesë e të legjitimojë faturime të kryera në kundërshtim me sa parashikuar në vendimmarrjet e ERE për përcaktimin e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, që nga hyrja në fuqi e metodologjisë përkatëse.

- Për sa i përket evidentimit të kostove të disbalancave në lidhje me FMF, OSHEE sh.a. informon se, i është drejtuar të gjithë klientëve të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin 35 kV me anë të shkresës nr. 10155 Prot, datë 07.05.2019, duke kërkuar nga ky grup klientësh ngarkesën e energjisë (konsumin e energjisë elektrike në njësi/kWh që u nevojitet) në profilin ditor/orar cdo ditë për ditën pasardhëse të parashikuar, i cili duhet të dërgohet nëpërmjet e-mailit duke bashkëngjitur dhe formatin e kërkuar për t'u plotësuar nga këta klientë deri në fund të vitit 2019, në mënyrë që OSHEE sh.a. të vijojë me blerjen e energjisë elektrike sipas kërkesës dhe nevojave që ka secili konsumator dhe për të analizuar kostot e disbalancave të krijuara nga blerja e energjisë në treg të parregulluar.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në Vendimin nr. 266, datë 21.12.2018 të bordit të ERE “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2019” është **0.75 lekë/kWh**.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në Vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 të bordit të ERE “Mbi lënien në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është **1.5 lekë/kWh**.
- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse rezulton që, çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **korrik 2019** të jetë **12.75 lekë/kWh**.
- OSHEE sh.a. me shkresën nr.14962, datë 26.07.2019 kërkon nga ERE saktësimin e periudhës nga e cila do të fillojë korrektimi i faturave për energjinë e faturuar në pik për klientin FMF.
- ERE e gjykon të drejtë zbatimin e korrektimit të faturave për energjinë e faturuar në pik për klientët FMF për të gjithë faturimet e kryera në pik për gjatë të gjithë periudhës që OSHEE sh.a. ka ushtruar funksionet si Furnizues i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në 35 kV.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12.75 lekë/kWh për muajin korrik 2019.
2. Korrektimin në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, të faturave për energjinë e faturuar në pik për klientët FMF, për të gjithë faturimet e kryera në pik për gjatë të gjithë periudhës që OSHEE sh.a. ka ushtruar funksionet si Furnizues i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në 35 kV.
3. OSHEE sh.a. të informojë ERE-n për ecurinë e zbatimit të pikës 2 të këtij vendimi, në aplikimin e rradhës për miratimin e çmimit të furnizimit nga furnizuesi I mundësisë së fundit për muajin gusht.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI